



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit



KONTRATË PUNE
KUSHTET E PËRGJITHSHME, TË VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

TITULLI: LOT III NDERTIMI I KOLEKTOREVE PËR GRUMBULLIMIN E UJRAVE TË ZEZA - VAZHDIM I PUNIMEVE TE KOLEKTOREVE NE DRENAS- POLAC PERFUNDIMI I RRJETIT KRYESOR

Numri identifikues: 611-20-036-521

Datë: 05.08.2020

Nr. i arkivit: 400-29660

NENI 1 PALËT NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT - DRENAS, përfaqësuar nga BLERIM NIKA, Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënës")

GR I OE N.P KONAKU & BENI CONSTRUCTION SHPK, -DRENAS përfaqësuar nga: METË BYTYQI- Drejtor (me tutje "Kontraktues")

NENI 1: LËNDA

Lënda e kontratës duhet të jetë kryerja e punëve nga Kontraktuesi në vijim: **LOT III NDERTIMI I KOLEKTOREVE PËR GRUMBULLIMIN E UJRAVE TË ZEZA -VAZHDIM I PUNIMEVE TE KOLEKTOREVE NE DRENAS- POLAC PERFUNDIMI I RRJETIT KRYESOR**

1.2 Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të Veçanta dhe të aneksit teknik [duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar].

1.3 Vendi i pranimit të punëve do të jetë: **LOT III NDERTIMI I KOLEKTOREVE PËR GRUMBULLIMIN E UJRAVE TË ZEZA -VAZHDIM I PUNIMEVE TE KOLEKTOREVE NE DRENAS- POLAC PERFUNDIMI I RRJETIT KRYESOR**

NENI 2 KOHA E PËRFUNDIMIT

2.1 Afati kohor për kryerje të punëve do të jetë: **Sipas Planit dinamik**. Operatori Ekonomik duhet të jetë në gjendje gadishmërie dhe sa herë që kërkohet duhet të angazhohet me inxhinier të natyrave përkatëse në mbikqyrjen e projekteve dhe në hartimin e projekteve dhe paramasave nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së punëve do të jetë: Komuna e Drenasit

NENI 3 ÇMIMI

ÇMIMI I KONTRATËS; = **105,565.50€ (Njëqindë e Pesëmijë e Pesëqindë e Gjashtëdhjetë e Pesë euro e 50 cent)**

NENI 4 RADHITJA E DOKUMENTEVE TE KONTRATËS SIPAS PRIORITETIT

Kontrata përbëhet nga dokumentet e mëposhtme, sipas prioritetit:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);
(Procesverbali i mbledhjes informative/vizitës se vendit)

Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

NENI 5 KOMUNIKIMET

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët [Angleze] [Shqipe] [Serbe]¹ në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve

PIESA II E KONTRATES KUSHTET E PËRGJITHSHME

NENI 1 PËRKUFIZIMET

"Kontratë" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Kontraktuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

"Punë" konsiderohen të gjitha ato punë të cilat janë objekt i kontratës dhe të cilat Autoriteti Kontraktues kërkon që të kryhen nga kontraktuesi, qofshin ato ndërtim, restaurim, meremetim apo rrënim ndërtesash, pajisje, struktura inxhiniering civil, struktura të tjera apo pjesë të tyre.

"Kontraktuesi" është operatori ekonomik (apo grupi i operatorëve ekonomik), i caktuar në formularin e kontratës, i cili (të cilët) është palë në kontratë dhe është i obliguar të kryejë punët sipas marrëveshjes dhe i cili do të marrë shumën sipas marrëveshjes me kontratë.

"Menaxheri i Projektit" është njeriu i caktuar në kushtet e veçanta të kontratës (apo cilido njeri kompetent i autorizuar nga Autoriteti Kontraktues), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së punëve dhe për të gjitha hollësitë duhet t'i raportojë Autoritetit Kontraktues.

1.5 "Çmimi Kontratës" do të thotë shuma që i paguhet Kontraktuesit sipas marrëveshjes në formularin e kontratës.

"Vendi i ndërtimit" do të thotë vendi i caktuar për kryerjen e punëve të kontraktuara.

"Pajisjet e kontraktuesit" do të thotë e tërë makineria përfshirë edhe atë për bartjen e pajisjeve, dhe mjetet tjera që nevojiten për kryerjen e punëve të kontraktuara që duhet të bëhen sipas kontratës.

"Skicat" nënkuptojnë vizatimet, llogaritjet, informatat e siguruar dhe të miratuara nga Autoriteti Kontraktues për kryerjen e punëve të kontraktuara.

"KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

¹ Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga ana e tenderuesit në këtë tender.

“KVK” do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

NENI 2 GJUHA DHE LIGJI I APLIKUESHËM

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

NENI 3 TRANSFERIMI

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Kontraktuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Kontraktuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Kontraktuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

në rast të dhënies së të drejtës së Kontraktuesit siguruesve të Kontraktuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Kontraktuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Kontraktuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

NENI 4

Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Kontraktuesi ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Kontraktuesi nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Menaxheri i Projektit. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Menaxherit të Projektit. Menaxheri i Projektit do ta lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Kontraktuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Kontraktuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Menaxherit të Projektit nuk e liron Kontraktuesin nga obligimet e tij sipas kontratës

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Kontraktuesit, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Kontraktuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

NENI 5 Personeli

5.1 Kontraktuesi duhet të punësoj personel kyç dhe të përdor pajisje të identifikuar në tender e tij, për të kryer punë ose personel tjetër dhe pajisje të aprovuara nga menaxheri i projektit. Menaxheri i Projektit do të aprovoj çdo zëvendësim të propozuar të personelit kyç dhe pajisjeve vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse, ose karakteristikat janë në thelb të barabarta ose më të mirë se ato të propozuara gjatë tenderit.

NENI 6 Obligimet e Kontraktuesit

6.1 Kontraktuesi duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Kontraktuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat. Ekzekutimi i urdhrat administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

6.2 Kontraktuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë

dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

6.3 Kontraktuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

6.4 Nëse Kontraktuesi është grup, përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

6.5 Kontraktuesi do të siguroj se punët do të fillojnë dhe të përfundojnë brenda afatit të caktuar rënë dakord në programin e bërë sipas Nenit 8.

6.6 Kontraktuesi do të siguroj që të gjitha punët që ai/ajo do të bëjë, si dhe riparimin e defekteve gjatë realizimit të punimeve do të bëhen në kohë dhe në përputhje me standardet, praktikat, metodat dhe procedurat ekzistuese dhe për më tepër me shkallën e aftësisë dhe zellit, e cila do të pritët nga një kontraktues i aftë dhe me përvojë që ka ndërmarr punë të ngjashme.

6.7 Kontraktuesi do të siguroj për cilësinë e punës dhe për cilësinë e materialeve dhe cilësisë profesionale të punonjësve që janë përdorur për realizimin e punëve të kontraktuara.

6.8 Kontraktuesi duhet të siguroj zonën e ndërtimit menjëherë pas fillimit të punës për arsyet e mëposhtme:

në qoftë se për kryerjen e punëve pajisjet e rënda si: ekskavatorë të llojeve të ndryshme, vinça, kamionë të llojeve të ndryshme, skela të larta, etj do të përdoren dhe

në mënyrë që të mos dëmtojë kalimtarët e rastit, objektet përreth, trafikun etj.

6.9 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në vend punim.

NENI 7 Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit

7.1 Nga data e fillimit e deri sa të lëshohet Certifikata e Korrigjimit të Defekteve, rreziqet e lëndimeve personale, vdekja, dhe humbja ose dëmtimi i pronës (përfshirë, pa kufizim, Punët, Impiantet, Materialet, dhe Pajisjet) janë rreziqet e Kontraktuesit dhe pronës së afërt.

7.2 Kontraktuesi duhet të siguroj një sigurim nga dita fillimit të punimeve deri në fund të periudhës garantuese të defekteve në shumat e përcaktuara në KVK për ngjarjet e mëposhtme të cilat janë për shkak të rreziqeve të Kontraktuesit:

humbje ose dëmtim i Punëve, Impianteve dhe Materialeve;

humbje ose dëmtim i Pajisjeve;

humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën; dhe dëmtim ose vdekje e personelit të tij.

7.3 Kontraktuesi brenda 15 ditëve pas nënshkrimit të kontratës duhet t'i dërgojë Autoritetit Kontraktues policën dhe certifikatën për sigurim që ka për qëllim kompensimin e nevojshëm për të siguruar humbjen apo dëmet e pësuar.

7.4 Në qoftë se kontraktuesi nuk ofron një sigurim të tillë atëherë kontrata do të konsiderohet e anuluar dhe kontraktuesi do të përjashtohet nga pjesëmarrja në aktivitetet e prokurimit për jo më pak se një vit.

7.5 Në qoftë se ekzistojnë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për zgjatjen e afatit të ofrimit të certifikatës mbi sigurim, Autoriteti Kontraktues mund të zgjasë afatin e caktuar për dorëzimin e certifikatës mbi sigurimin ose të eliminojë sigurimin dhe të zbresë çmimin e shpërblimit nga fitimi i kontra

NENI 8 Programi

8.1 Brenda kohës se specifikuar në KVK, kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit një program për miratim. Programi do të përmbajë se paku me se vijon: mënyrën se si Kontraktuesi propozon ekzekutimin e punëve, afatin kohor që kërkohet për dorëzim dhe miratim të vizatimeve, metodat e përgjithshme që do të zbatohen, dhe afatin kohor për secilin aktivitet të specifikuar.

8.2 Nëse menaxheri i projektit për më tepër kërkon modifikime në programin e punëve në kuadër të punëve të kontraktuara, kontraktuesi duhet ta rishikojë edhe njëherë programin dhe t'ia kthejë prapë Menaxherit të projektit. Kontraktuesi do të azhurnoj Programin në intervale jo më shumë se periudha e përcaktuar në KVK.

8.3 Për çdo pakënaqësi apo mosmarrëveshje në lidhje me modifikimin e programit, kontraktuesi do të sigurojë argument me shkrim Menaxherit të Projektit.

8.4 Paraqitja e programit të tillë, duke përfshirë çdo shtesë nga menaxheri i projektit nuk do të zvogëlojë ose të rris detyrimet e kontraktuesit sipas punëve të kontraktuara, si dhe çdo modifikim të përfshirë në programin e punimeve nuk do të rezultojë në ndonjë pagesë shtesë për kontraktuesin, nëse kjo ka ndodhur si pasojë e neglizhencës së kontraktuesit gjatë përpilimit të programit.

NENI 9 Inspektimi dhe testimi

Autoriteti Kontraktues do të emëroj "Menaxherin e Projektit", të cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e ekzekutimit të punëve gjatë tërë kohës, duke filluar që nga dita e parë e fillimit të punëve e deri në skadimin e periudhës garantuese të defekteve dhe për raportim tek Autoriteti Kontraktues.

Qëllimi i mbikëqyrjes është të kontrollojë cilësinë e punëve dhe cilësinë e materialeve të përdorura në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

Kohën dhe vendin për testim do ta caktojë Menaxheri i Projektit.

9.4 Koston e testimit si dhe çdo gjë tjetër në lidhje me testimin do të sigurojë kontraktuesi, në pajtim me specifikimet teknike të rëna dakord.

9.5 Në qoftë se Menaxheri i Projektit ose kontraktuesi nuk pajtohen me rezultatet e testimit, mund të caktojnë kohën dhe vendin për ri-testim. Koston e ri-testimit e siguron pala e cila ka gabuar në rezultatet e testimit. Në qoftë se pas testimit, Menaxheri i Projektit konstaton se cilësia e materialeve nuk është e cilësisë së materialeve të specifikuar, ka të drejtë të kërkojë nga kontraktuesi ndërrimin e materialit pa ndryshuar çmimin kontraktues.

NENI 10 Fillimi i punëve

10.1 Kontraktuesi do të fillojë punët brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

10.2 Kontraktuesi do të ndërtoj dhe instalojë Punët në pajtim me Specifikimet dhe Vizatimet dhe Punët do të kryhen në pajtim me Programin e dorëzuar nga Kontraktuesi, i përditësuar me miratimin e Menaxherit të Projektit, dhe do të plotësojë ato brenda afatit kohor të specifikuar në KVK.

NENI 11

Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

11.1 Kontraktuesi mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;

Forca madhore të përkufizuara si në Nenin 30;

11.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kuptuar se mund të ketë vonesë, Kontraktuesi duhet ta lajmërojë Autoritetin Kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditësh i jep Autoritetit Kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

11.3 Brenda 30 ditësh pas pranimit të detajeve sipas Nenit 11.2 Autoriteti Kontraktues do të lejojë me shkrim Kontraktuesit këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Kontraktuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

NENI 12

Paralajmërim i hershëm

12.1 Kontraktuesi pa humbur kohë do të informojë Menaxherin e Projektit, në qoftë se vëren ndonjë gabim apo lëshim në skica (vizatime) apo edhe në specifikim gjatë kryerjes së punëve duke ia tërhequr vërejtjen se ato mund të ndikojnë me vonë në kualitetin e punëve.

12.2 Nëse Menaxheri i Projektit vëren ekzistimin e disa gabimeve apo lëshimeve, qofshin ato në skica apo në specifikim teknik, ai/ajo do t'i evitojë menjëherë dhe do t'i konsiderojë pasojat.

12.3 Nëse palët në kontratë vlerësojnë se ndërrimet substanciale të punëve janë bere të nevojshme për shkak të gabimeve të tilla ose të përjashtimeve të cilat substancialisht ndikojnë në çmimin e kontratës, atëherë Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me autoritetin kontraktues do të korrigojnë dhe kompensojnë situatën sipas Ligjit të Prokurimit Publik.

NENI 13

Korrigjimi i defekteve

13.1 Menaxheri i Projektit do të njoftoj Kontraktuesin mbi ndonjë defekt para përfundimit të periudhës garantuese të defekteve, e cila fillon në Përfundim. Kohëzgjatja e periudhës garantuese të defekteve është përcaktuar në KVK. Periudhës garantuese e defekteve do të zgjatet deri sa të përmirësohen defektet.

13.2 Çdo here që epet njoftim mbi Defektet, Kontraktuesi do t'i korrigjoj defektet brenda afatit kohor të specifikuar në njoftimin e Menaxherit të Projektit.

13.3 Kontraktuesi do t'i eliminojë defektet dhe do të arrijë cilësinë e duhur të punës brenda kohës së caktuar nga Menaxheri i Projektit dhe kjo do të arrihet pa ndryshimin e çmimit të kontratës.

13.4 Në qoftë se Kontraktuesi nuk ndërmerr masa për të korrigjuar defektet e evidentuara nga Menaxheri i Projektit brenda afatit të caktuar, Menaxheri i Projektit do t'i vlerësojë defektet ose do të angazhojë një person të tretë për t'i eliminuar defektet.

13.5 Autoriteti Kontraktues do të kërkojë nga kontraktuesi kompensim ose do të kalkulojë shumën e vlerësuar në çmimin përfundimtar të kontratës.

NENI 14

Paramasa dhe Paralogaria

14.1 Paramasa dhe paralogaria duhet të përmbajnë pajisje për ndërtim, instalim, testim, dhe punën e komisioneve që duhet të kryhet nga ana e Kontraktuesit. Paramasa dhe paralogaria përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktuesi do të paguhet për sasinë e punës së kryer në normën e Paramasës dhe Paralogarisë për çdo artikull.

14.2 Në rast të kontratës paushallë, Përshkrimi i Aktivitetit duhet të përmbaj aktivitetet me çmim për punët e kryera nga ana e Kontraktuesit. Përshkrimi i Aktivitetit përdoret për monitorim dhe kontroll të kryerjes së aktiviteteve në bazë të të cilave Kontraktuesi do të paguhet. Nëse pagesa për Materiale në vend punim do të bëhet veç e veç, Kontraktuesi do të tregoj shpërndarjen e Materialeve në vend punim veçmas në Përshkrimin e Aktivitetit.

NENI 15

Vërtetimet e pagesës

15.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të projektit raportet mujore të çmimeve të vlerësuara të punëve të përfunduara me minus shumën kumulative të vërtetuar më parë.

15.2 Menaxheri i Projektit do ta kontrollojë punën e kryer të kontraktuesit për të vërtetuar cilësinë e punës dhe vërteton shumën që duhet t'i paguhet kontraktuesit.

Vlera e punës së kryer do të përcaktohet nga Menaxheri i Projektit.

Vlera e punës së përfunduar përfshin:

Në rastin e Kontratës së Paramasës dhe Paralogarisë, vlera e sasisë së punës në Paramasë dhe Paralogari që është përfunduar; ose

Në rast të kontratës paushallë, vlera e punës së ekzekutuar do të përbëjë vlerën e aktiviteteve të përfunduara në Përshkrimin e Aktivitetit.

Vlera e punës së përfunduar përfshin vlerësimin e ndryshimeve dhe shkaqeve për kompensim.

NENI 16

Pagesa

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro.

16.2 Pagesat do të rregullohen për zbritje për pagesat paradhënie dhe të mbajtjes. Autoriteti Kontraktues duhet të paguaj Kontraktuesit shumën e certifikuar nga Menaxheri i Projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate. Nëse Autoriteti Kontraktues bën një pagesë me vonesë, Kontraktuesit do ti paguhet interes për pagesë me vonesë në pagesën e ardhshme. Interesi do të llogaritet nga data në të cilën pagesa duhet të ishte bërë, deri në datën kur pagesa

është bërë me vonesë, e rregulluar sipas bankave vendase për kredi në sektorin e ndërtimit.

16.3 Artikujt e Punëve për të cilat nuk është dhënë normë apo çmim nuk do të paguhet nga Autoriteti Kontraktues dhe do të konsiderohen të mbuluara nga normat dhe çmimet tjera në Kontratë.

16.4 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Kontraktuesi do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Kontraktuesi. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

NENI 17 **Shkaqet për kompensim**

17.1 Shkaqe për kompensim konsiderohen ngjarjet si në vijim:

Autoriteti Kontraktues nuk lejon qasje në një pjesë të vend ndërtimit data e posedimit e specifikuar në KVK. Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatin e caktuar si në kontratë.

Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt.

Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.

Parapagimi vonohet.

Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës. Kontraktuesi has në pengesa për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

17.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

NENI 18 Tatimi

18.1 Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

18.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

18.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.

18.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi.

NENI 19 **Dëmet e likuiduara**

19.1 Kontraktuesi do të paguajë dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkalojë shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Kontraktuesit. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikojë në detyrimet e Kontraktuesit.

NENI 20 **Parapagimi**

20.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesë paradhënie Kontraktuesit të shumave të përcaktuara në KVK nga data e caktuar në KVK kundër dispozitës nga Kontraktuesi i një Garancioni të Pakushtëzuar Bankar në një formë dhe nga një bankë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues në sasi dhe valutë të barabartë me parapagim. Garancia do të mbetet në fuqi deri sa të bëhet pagesa e parë, por shumën e garancisë duhet të reduktohet në mënyrë progresive nga shumën që paguhet nga Kontraktuesi. Interesi nuk do të paguhet për parapagim.

20.2 Kontraktuesi do të përdorin parapagimin vetëm për të paguar Pajisjet, materialet dhe shpenzimet e tjera të

nevojshme posaçërisht për kryerjen e punëve. Kontraktuesi duhet të dëshmoj se pagesa paradhënie është përdorur në këtë mënyrë me furnizim të kopjeve të faturave ose dokumenteve të tjera për Menaxherin e Projektit.

20.3 Parapagim do të paguhet duke zbritur shuma proporcionale nga pagesat përndryshe për shkak të Kontraktuesit, pas orarit të përqindjeve të përfunduar të Punëve në bazë të pagesës.

NENI 21 **Mbajtja e Parasë**

21.1 Shuma, e specifikuar në KVK, do të ndalohet nga çdo pagesë e Kontraktuesit deri në përfundim e tërë të Punëve. Kjo shume ne asnjë rast nuk do të tejkaloj 10% e vlerës totale të kontratës origjinale.

21.2 Me lëshimin e Certifikatës mbi Përfundimin e Punëve nga ana e Menaxherit të Projektit, shuma totale e ndaluar do t'i paguhet Kontraktuesit kur të kaloj periudha garantuese e Defekteve dhe Menaxheri i Projektit ka vërtetuar se Defektet e njoftuara nga Menaxheri i Projektit Kontraktuesit para përfundimit të kësaj periudhe janë korrigjuar. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar "me kërkesë".

NENI 22 **Siguria e ekzekutimit**

22.1 Kontraktuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.

22.2 Sigurimi do të vazhdoj të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

22.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

NENI 23 **Kostoja e Riparimeve**

23.1 Humbja ose dëmtimi i Punëve ose Materialeve që do të përfshihen në Punët në mes të Datës së fillimit dhe në fund të periudhës së Korrigjimit të Defekteve do të rregullohet nga Kontraktuesi në koston e Kontraktuesit nëse humbja ose dëmtimi lind nga aktet ose mosveprimet e Kontraktuesit.

NENI 24 **Përfundimet dhe Certifikata e pranimit të punëve**

24.1 Pasi që kryesisht të jenë përfunduar të gjitha punët dhe të kenë kaluar të gjitha Testet e kompletimit të punëve të përshkruara në kontratë, kontraktuesi mund të njoftoj Menaxherin e Projektit me një njoftim me shkrim se do të kryej të gjitha punët e diskutueshme gjatë Periudhës Garantuese të defekteve. Ky njoftim dhe ky zotim se të gjitha punët e diskutueshme do të kompletohen gjatë Periudhës garantuese për defekte do të merren si kërkesë e Kontraktuesit për Menaxherin e Projektit për lëshim të Certifikatës-mbi-Pranim të punëve.

24.2 Brenda 21 ditëve të pranimit të kësaj kërkesë Menaxheri i Projektit ose do të lëshoj Certifikatën e pranimit të punëve, duke cekur datën, sipas mendimit të tij, e përfundimit të punëve ose do të jap instruksione për punët të cilat duhet të kryhen nga ana e Kontraktuesit para lëshimit të kësaj Certifikate.

24.3 Kontraktuesi, me pëlqimin e Menaxherit të Projektit, ka të drejtën e pranimit të kësaj Certifikate brenda 21 ditëve të kompletimit të punëve dhe të përmirësimit të defekteve të cekura.

24.4 Autoriteti Kontraktues do të marrë përsipër vend punimin dhe punët brenda shtatë ditëve nga lëshimi i certifikatës së përfundimit nga Menaxheri i Projektit.

NENI 25 **Llogaritja përfundimtare**

25.1 Kontraktuesi do t'i dorëzojë Menaxherit të Projektit llogarinë e cila përfshin në detaje të gjitha punët të cilat duhen të paguhet Kontraktuesit sipas kontratës para përfundimit të Periudhës garantuese për defekte. Menaxheri i projektit do të lëshoj Certifikatën e periudhës garantuese të defekteve dhe do të certifikoj cilëndo pagese finale e cila 8

duhet ti paguhet Kontraktuesit brenda 15 ditëve pas pranimit të llogarisë nga ana e kontraktuesit nëse nuk vëren të meta. Nëse llogaritja përfundimtare e kontraktuesit nuk është e plotë apo është e pa saktë, Menaxheri i Projektit brenda 15 ditësh do të paraqesë një plan që paraqet fushëveprimin e korrigjimeve dhe shtesave që janë të nevojshme. Nëse llogaria përfundimtare edhe pas ri-dorëzimit akoma mbetet e pakënaqshme, Menaxheri i Projektit do të vendos mbi shumën e cila do të paguhet Kontraktuesit dhe do të lëshojë certifikatën mbi pagesën.

NENI 26 **Shkëputja e kontratës**

26.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

26.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
Kontraktuesi vonohet në përbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

26.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 26.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

26.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesit do të përfundojë vazhdimësinë e përbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

26.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vendpunimin dhe ta lirojë vendpunimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

NENI 27 **Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

27.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

27.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës

NENI 28 Prona

28.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

NENI 29 Lirimi nga Ekzekutimi

29.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

NENI 30

Forca madhore

30.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktoar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

30.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejt që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.

ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

NENI 31

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

NENI 32

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

ose vendim nga gjyqi;

kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

32.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	Të përgjithshmet
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
Gjuha e përdorur	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [<u>gjuha e procedurës - shqipe</u>].
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	7.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve: (sipas ligjeve në fuqi) humbje ose dëmtim i Pajisjeve deri në shumën e kontratës; humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën deri në shumën e kontratës; dëmtim personal ose vdekje: të punëtorëve të Kontraktuesit: sipas ligjeve në fuqi. (ii) të personave të tjerë: sipas ligjeve në fuqi.
Programi	8.1	Menaxherët e Kontraktuesit dhe Autoritetit kontraktues duhet ta hartojnë Planin e Menaxhimit të kontratës konform Neni 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës. Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Neni 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktot me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Njësia kërkuese dhe komisionin për pranim teknik me një Vendim tjetër . Të dy palët obligohen të mbajnë ditarin e punës dhe nga një kopje të dorëzohen në arkivin e dosjes për pagesë.
Programi i azhuruar dhe pagesat	8.2	Periudha për Programin e azhurnuar sipas planit dinamik . Pagesat kryhen ashtu si raporton Organi mbikqyrës, pagesa e fundit kryhet vetëm pasi të ofrohet Garancioni për eliminim e të metave në shumën prej 10 % të vlerës së ofertës.

Inspektimi dhe testimi	9.1	Inspektimin dhe testimin e materialeve e kryen Menaxheri sa herë që kjo shihet e nevojshme. Shpenzimet për testimet e para i kryhen Punëkryrësi, ndërsa herave tjera (kur Menaxheri nuk është i kënaqur) kryhen nga Autoriteti Kontraktues.
Fillimi i punëve	10.1	Data e fillimit do të jetë 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës. Punëkryrësi duhet ta ketë në vendpunishte çdo herë Inxhinierin e prezentuar në dosje të tenderit (RIJAD ZEJNELI) inxh. i ndërtimtarisë- Drejtimi i Hidros). Nëse pas urdhërit prej tre ditëve nuk paraqitet Inxhinieri i OE në vend punishte, Komuna ka të drejten t'i jap urdhresen e fundit për nderprerje të kontratës. Poashtu njëjtë vepron edhe kur nuk i angazhon paisjet me të domosdoshme në vendpunishte. Inxhinieri duhet të nënshkruhet çdo herë në situacionet e hartuara nga OE fitues dhe në fletët e ditarit të punës. Ndërrimi evnetual i inxhinierit të paraqitur në dosje bëhet vetëm me një arsytim bindës, me Pëlqim të Menaxherit komunal.
Nënkontraktimi	10.2	OE i lejohej nënkontraktimi deri në 10% të vlerës së kontratës, mbi këtë përqindje dhe deri në 40 % të shumës së kontratës vetëm me aprovimin e Menaxherit dhe Organit mbikqyrës të caktuar nga komuna.
Mbarimi i punimeve	10.3	Data e përfundimit të të gjitha Punëve do të jetë: Sipas Planit dinamik dhe Planit të menaxhimit të kontratës të nënshkruar nga të dy palët.
Përmirësimi i I defekteve	13.1	Periudha garantuese e defekteve është 2 vite.
Shkaqet për kompensim	17.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë sipas kërkesave dhe paraqitjes së rasteve nga Drejtoria për Infrastruktur Publike.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës. Me propozimin e Menaxherit të Projektit dhe aprovimin e Autorizuesit Operatori Ekonomik futet në penale nëse ka tejkalim të ditëve. Nëse ka tejkalim të ditëve dhe Operatori Ekonomik nuk është fut në penale atëherë Menaxheri duhet të jap një arsytim për mos futje në penale.
Monitorimi	19.2	Menaxheri i projektit obligohet që monitorimin e kontratës në aspektin Ligjor herë pas here ta kryej konform neneve të kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe duhet të bindet se kontrata implementohet ashtu edhe si është hartuar. Në rast të kërkesës për nderprerje të punimeve apo kontratës, Menaxheri i Projektit duhet ta njoftoj ZP duke ia bashkangjite të gjitha shkresat, komunikimet, dhe të bindet se janë shterre të gjitha mundësitë konform neneve të kushteve të kontratës. Poshtu merrë përsipër së bashku me Avokatin komunal të përballet edhe me pengesat eventuale dhe mbrojtjen e kontratës dhe interesave të Komunës para institucioneve tjera.
Parapagimi	20.1	<i>Shuma e parapagimit (avans) :0</i>
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: 0 %
Siguria e ekzekutimit	22.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 15 % e shumës së ofertës, validiteti i sigurimit sipas Planit dinamik, plus 30 ditë tjera.

Pagesa pas shkëputjes së kontratës	27.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha punët e kryera dhe të papaguara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	31.2	Mundësisht në mes të dy palëve.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [jykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë.
Mbikëqyrja	33.1	Menaxher apo Mbikqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marrë pjesë në hartimin e paramasave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave. Menaxheri i projektit duhet të veproj konform Udhëzimit A01, përkatësisht Nenit 61.
Punët shtesë	33.2	Do të ecet me procedurë për punë shtesë nëse paraprakisht merret autorizimi nga Mbikqyrësi dhe ZKA-ja.
Pagesat	33.3	Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për punët e kryera do të caktohet nga Menaxheri i Projektit.
Dorëzimi i dokumentave	33.4	Zyrtari ndërlidhës apo Menaxheri para se ta dërgoj dokumentacionin për pagesë në Thesar duhet të binden se ju kanë ofruar të gjitha dokumentet si: Plani i menaxhimit të kontratës , aktvendimet, procesverbalet, raportet, situacionet për punët e kryera të nënshkruara nga inxhinierët, faturat, atestet për materialet e përdorura, shkresat, fletët e ditarit të punës të nënshkruara nga inxhinierët, arsyetimin për tejkalimin e ditëve kalendrike, sigurimet, etj, në të kundërtën e merrë përgjegjësinë.
Arkimi i dokumentave	33.4	Zyrtari ndërlidhës dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë. Një kopje e faturës, raportit të pranimit pas përfundimit të projektit duhet të dorëzohen në ZP.
Hyrja në fuqi	33.5	Kontrata hynë në fuqi 3 ditë pas nënshkrimit të palëve ose si ditë zyrtare do të konsiderohet dita kur Menaxheri jep urdhër për fillimin e punimeve. Kontrata hartohet në 3 kopje origjinale. Vendimi mbi caktimin e Menaxherit dhe Plani i menaxhimit duhet të hartohet menjëherë pas nënshkrimit të kontratës por asesi pas fillimit të punimeve.

Kësaj kontrate i bashkangjitet:Oferta financiare e Tenderuesit (Paramasa dhe paralogjaria e çmimeve).

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	BLERIM NIKA	EMRI:	METË BYTYQI
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:	<i>Blerim Nika</i>	Nënshkrimi:	<i>Metë Bytyqi</i>
Data:	<i>06.08.2020</i>	Data:	<i>06/08/2020</i>
Vula:		Vula:	



PLANI DINAMIK

KOMUNA GLOGOC


**NDËRTIMI I KOLEKTOREVE PËR GRUMBULLIMIN E
UJERAVE TË ZEZA NË KOMUNËN E DRENASIT**

Nr. Prokurimit: 611-20-1771-5-2-1

Investitori:

Projekti:


Poz.	Përshkrimi i punëve	Ditët: 70 Ditë																
		JAVA 1	JAVA 2	JAVA 3	JAVA 4	JAVA 5	JAVA 6	JAVA 7										
	LOT III - NDËRTIMI I KOLEKTOREVE PËR GRUMBULLIMIN E UJERAVE TË ZEZA VAZHDIM I PUNIMEVE TE KOLEKTOREVE NE DRENAS -POLAC PERFUNDIMI I RRJETI KRYESOR																	
1	PUNET PREGADITORE																	
2	PUNET E DHEUT																	
		JAVA 8	JAVA 9	JAVA 10	JAVA 11	JAVA 12	JAVA 13	JAVA 14										
3	PUNET LATUESE (VENDORISJA E GYPAVE TË KANALIZIMIT)																	
4	SHQYRTIMI RRJETIT																	



LOT-3 PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PROJEKTIT DETAL TE KOLEKTORAVE TE UJERAVE TE ZEZA POLAC-DRENAS					
Ndërtimi i Kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit-vazhdim i punimeve në Kolektorët Drenas-Polac					
1 PUNET PREGADITORE					
NR.	Përshkrimi i Pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi (€)	Gjithësej (€)
1.1	Shënimi i kantiertit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet kanalizimi sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatën punimet.Llog në m'	m'	1665	1.00 €	1,665.00
1.2	Punët parapërgatitore, shënimi gjeodezik si dhe verifikimi i trasesë së vjetër të kanalizimit ,në matjet gjeodezike të përfshihen të gjitha punët e përmendura në kushtet e përgjithshme dhe teknike, po ashtu të maten diznivelet dhe të mundësohet kyqja e kolektorve të vjetër në kolektorin e ri sipas projektit dhe detaleve teknike. Llog në m'. Vërejtje: Obligohet kontraktori i punimeve qe pas përfundimit te punimeve te beje inqizimin gjeodozik te ekzekutimit te punimeve me kordinata x,y,z dhe ta derzoje ne cd dhe kopje fizike.Vërejtje:Inqizimi gjeodezik për koordinatën e "Z" të mirret mbi kapok dhe në fund të gypit në çdo pusetë. (ne formatin shapëfile 3 kopje fizike dhe 1 eletronike)	m'	1665	0.20 €	333.00
1.3	Pastrimi i terrenit nga mbeturinat,e ngurta,shkurret drunjët- në zonat ku do të katojë traseja e kanalizimit . Pastrimi i tyre bëhet normal me rjedhën e kanalizimit me gerësi 3m për ti mundësuar futjen normale të makinerisë së gërmimi si dhe Largimin e tyre në deponi,Deponin e caktion Investitorit.. Në këtë pozicion përfshihet edhe demolimi i rethojave (gardheve neper ara) dhe kthimin në gjendje të mëparshme pas përfundimit të punimeve. Llog ,në m²	m2	1665	1.00 €	1,665.00
GJITHËSEJ PUNIMET PREGADITORE					3,663.00
2 PUNET E DHEUT					
2.1	Gërmimi dhe hapja e kanalit për tokë fushore të kategorisë III-VI në thellësi prej 0.8 m' deri në thellësinë 6 m' për kanalizimi Fekal dhe gjerësi të nevojshme për punë duke përcjellë të gjitha pikat gjeodezike sipas profilit gjatësorë dhe dispozitës së projektit . Pas hapjes së kanalit të ngjeshet me vibrator pjesa e trases së kanalizimit. Vërejtje: Sigurimin nga shembja duhet ta bëjë punëkryesi, sipas detaleve teknike të përfshira në projekt. Sqarim : Ky lloj e kategorisë së dheut përfshinë të gjithë zone ku kalon traseja e kanalizimit duke filluar prej Stacionazhes 0.00 deri në përfundim të kanalizimit në stacionazhen e fundit.				
	Punët me makineri (90%)	m3	5300	2.00 €	10,600.00
	Punët me dorë (10%)	m3	800	3.00 €	2,400.00
2.2	Gërmimi dhe hapja e dheut për tokë fushore të kategorisë III-IV për hapjen e pusetave të kanalizimit në bazë të detaleve , skicave të përfshirë në projekt.				
	Punët me makineri (90%)	m3	136	4.00 €	544.00
	Punët me dorë (10%)	m3	8.5	6.00 €	51.00
2.3	Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së pusetës nga materiali guror para se të beonohet kineja (Bazamenti pusetës) ,Fraksion [0 deri 63] mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=250 kg/cm2 . Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve. Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.	m3	80	10.00 €	800.00
2.4	Furnizimi dhe shtrirja e Rërës 0-16mm, trashësi 10cm për shtatin nën gyp me planifikim ±3cm, dhe 15 cm mbi gyp për mbulimin dhe mbrojtjen e gypit . sipas vërejtjeve dhe përshkrimeve teknike paraprake të specifikuar për punimet tokësore. Gjatë vendosjes së rërës të aplikohet gjanometria të përcaktuar në bazë të rregullave dhe standardeve për aplikimin të materialeve ndërtimore në vepër. Llog m3	m3	828	4.00 €	3,312.00
2.5	Largimin e ujërave nëntaksorë të cilët shfaqen gjatë gërmimit të kanalit, të cilët pengoj ecurin e punës në instalimin e rrejtit të kanalizimit. , Llog, me ore/pune me aprovimin e organit mbikqyres	orë/pun e	45	50.00 €	2,250.00
2.6	Vendosja e trakës mbrojtëse sinjalizuese me gjerësi 3 cm përgjatë gjitha trasesë së rrejtit të kanalizimit . për ta identifikuar zonën se ku rradhet gypat pas mbulimit të kanalit."KUJDES GYP KANALIZIMI"	m'	1665	0.20 €	333.00
2.7	Mbushja dhe mbulimi e kanalit pas vendosjes së gypit me sasi të dheut të përgjedhur pa gurë me trashësi sipas skicave dhe detaleve te percaktuara ne projekt per secilen pusetë /stacionazh, pastaj vendoset pjesa tjetere e dheut deri në mbushje përfundimtare të terrenit dhe kthimi në gjendje të mëparshme , dheu i tepër largohet në deponin më të afërt deri në 15 km largësi.	m3	4435	0.50 €	2,217.50
GJITHËSEJ PUNIMET E DHEUT					22,507.50



3 PUNET LATUESE (VENDOSJA E GYPAVE TË KANALIZIMIT)					
3.1	Furnizimi dhe punimi i bazamentit të pusetave prej betoni C- 25/30 të armuar me klasë të armatures S-400/500 me trashësi d=25.0cm i papërshkueshem nga uji me dimensione (1.7x1.7)m ² si dhe punimi i kinetës së pusetës duke i dhënë ramjen e duhur në drejtim të rrjedhës së kolektorit sipas detajit teknikë të prezentuar në projekt. Furnizimi dhe montimi i tubave të betonit 1200 mm nga betoni i parafabrikuar i papërshkueshem nga uji. Kompania ekzekutuese është e obliguar që ta bëjë montimin dhe lidhjen në mes gypave në mënyrë profesionale duke filluar prej montimit të gypit mbi kinetë dhe vazhdon me lartësi të ngritje deri të kuota gjeodezike të përcaktuar në profilin gjatësorë të projektit të përfshirë edhe konuset pa kapakë. Lidhja e gypave në mes veti bëhet me llaç çimentoje me raport të reçetës 1:3. Në këtë pozicion përfshihet edhe Furnizimi dhe punimi i shkalleve nga metali fi 22 mm i cili perforcohet me bulona M22 të cilat duhet të montohen në pusetat kontrolluese me thellësi të renies λ=25 cm të hapit të shkallës deri në thellësinë e nevojshme për zbritje dhe ngritje sipas rregullave dhe standardeve si dhe skicës dhe detaleve të përfshira në projekt. Log në copë me të gjitha shpenzimet dhe punët të lartëcekura të përfshira në këtë projekt. Kompania punëkryese është e obliguar t'i prezentojë atestet e kualitetit materialit para fillimit të punimeve.	copë	35	25.00 €	875.00
3.2	Furnizimi dhe punimi i bazamentit të pusetave prej betoni C- 25/30 të armuar me klasë të armatures S-400/500 me trashësi d=25.0cm i papërshkueshem nga uji me dimensione (1.7x1.7)m ² si dhe punimi i kinetës së pusetës duke i dhënë ramjen e duhur në drejtim të rrjedhës së kolektorit sipas detajit teknikë të prezentuar në projekt. Furnizimi dhe montimi i tubave të betonit 1000 mm nga betoni i parafabrikuar i papërshkueshem nga uji. Kompania ekzekutuese është e obliguar që ta bëjë montimin dhe lidhjen në mes gypave në mënyrë profesionale duke filluar prej montimit të gypit mbi kinetë dhe vazhdon me lartësi të ngritje deri të kuota gjeodezike të përcaktuar në profilin gjatësorë të projektit të përfshirë edhe konuset pa kapakë. Lidhja e gypave në mes veti bëhet me llaç çimentoje me raport të reçetës 1:3. Në këtë pozicion përfshihet edhe Furnizimi dhe punimi i shkalleve nga metali fi 22 mm i cili perforcohet me bulona M22 të cilat duhet të montohen në pusetat kontrolluese me thellësi të renies λ=25 cm të hapit të shkallës deri në thellësinë e nevojshme për zbritje dhe ngritje sipas rregullave dhe standardeve si dhe skicës dhe detaleve të përfshira në projekt. Log në copë me të gjitha shpenzimet dhe punët të lartëcekura të përfshira në këtë projekt. Kompania punëkryese është e obliguar t'i prezentojë atestet e kualitetit materialit para fillimit të punimeve.	copë	25	25.00 €	625.00
3.2	Furnizimi dhe vendosja e kapakeve të pusetav Ø1200 mm , nga materiali nga betoni i armuar me armature rreze i pa pershkueshem nga uji , 12cm ² trashesi, per mos depertimin e ujerave atmosferike ne puseten e kanalizimi fekal. Sipas detali te prezentuar ne projekt. Kompania punëkryese është e obliguar t'i prezentojë atestet e kualitetit materialit para fillimit të punimeve.	copë	60	25.00 €	1,500.00
3.3	Vendosja e unazave për nivelizimin e depërimit të gypit i cili futet në pusetë betoni me dimensione sipas projektit , e cila mbështetë në kinet për shkarkimin e kontrolluara të ujit kanalizimit në pusetë, unaza vendosen ne te dy anet e depertimit te gypit në kinet dhe në depërimitin e pusetës duhet përfordohet me fugal llaç me raport 1:1 sipasi skicës së projektit dhe standardeve dhe rregulloreve teknike ne fuqi. Vërejtje : Gjatë ekzekutimit të punimeve duhet patur kujdese që të ndërmirren të gjitha mosha izoluese që parandalohet rrjedhja para se të futet në puset uji fekal dhe mos shkaktohen ndotje ambientale. Llog ne cope Kompania punëkryese është e obliguar t'i prezentojë atestet e kualitetit materialit para fillimit të punimeve.				
	Furnizimi vendosja e unazave me dim. DN 630 mm	copë	10	5.00 €	50.00
	Furnizimi vendosja e unazave me dim. DN 800 mm	copë	76	5.00 €	380.00
3.4	Furnizimi dhe vendosja e gypave të brinjëzuar të kanalizimit HDPE me dimensione sipas projektit te kualitetit PSN8, përgjatë gjithë gjatësisë së trases së kanalizimit, duke përcjellur nivelimin dhe pjerrtësin e ramjes në bazë projektit, me të gjitha elementet përcjellëse duke vendosur unaza nga gama ku liçhen gypat për të parandaluar lëvizjen e gypave dhe duke pamundësuar hyrjen e gjesendeve të ngurta të cilët bllokojnë gypin. Gjatë ekzekutimit te projektit te rrespektohen detajet teknike te perfshire ne prenen terthore dhe gjatesore po ashtu te rrespektohen kuota gjeodezike te perfshira projekt dhe standardeve dhe rregulloreve teknike ne fuqi. Kompania punëkryese është e obliguar t'i prezentojë atestet e kualitetit materialit para fillimit të punimeve.				
	Gyp i brinjëzuar të kanalizimit HDPE DN 630 PSN8	m'	550	31.00 €	17,050.00
	Gyp i brinjëzuar të kanalizimit HDPE DN 800 PSN8	m'	1115	50.00 €	55,750.00




3.5	Depertimi (kalimi) i gypin nen asfalt dhe lumenje behet me makineri shpuese me shpim horizontal, pune kryesi duhet patur kujdes te percaktoj sakte thellesin e lejuar te depertimi duke i rrespektuar ramjen e terrenit dhe kuotat gjeodezike te perfshira ne projekt , depertimi behet me gyp çeliku te kualitet larte me dimensione sipas projektit , bazamenti i gypit perforcohet me beton ne kinelën e pusetave . Verëjtje cdo demtim i bazes se asfaltit apo bazës së rrugës nga pakujdesia pergjegjjes eshte pune kryesi eshte i obliguar ti riparoj demet dhe ta kthej ne gjencje te meparshme funksionale.				
	Gyp çeliku te kualitet larte DN 650 mm	m'	20	50.00 €	1,000.00
	Gyp çeliku te kualitet larte DN 850 mm	m'	10	50.00 €	500.00
GJITHESEJ PUNIMET LATUESE					77,730.00
4 SHQYRTIMI RRJETIT					
4.1	Ekzaminimi dhe shqyrtimi i rrjetit të kanalizimit të jashtëm. Në marrëveshje me projektuesin, kryejn në tërësi testin e rrjetit. Mbushja e rrjetës me ujë në presionin e dhënë mbahet së paku 3 orë, ku evidentohen dhe regjistrohen të gjitha të dhënat.Në rast të defektëve , derdhet uji eliminohet çdo defektë dhe përsëritet testet.Ekzaminimi kryhet në praninë të autoritetit mbikqyrës dhe personit të autorizuar,ku bëhet një raport i veçantë. Llogaritja m'	m'	1665	1.00 €	1,665.00
GJITHESEJ PUNET E SHQYRTIMIT RRJETIT					1,665.00





NR	REKAPITULLIMI I PROJEKTI	
1	GJITHËSEJ PUNIMET PREGADITORE	3,663.00
2	GJITHËSEJ PUNIMET E DHEUT	22,507.50
3	GJITHËSEJ PUNIMET LATUESE	77,730.00
4	GJITHËSEJ PUNET E SHQYRTIMIT RRJETIT	1,665.00
TOTAL I PËRGJITHSHËM		105,565.50

Të gjithë O.E kanë të drejtë të parashtrajnë pyetjet në lidhje në pozicionet brenda afatit Ligjor.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (O.E)	
Emri i OE:	N.P "KONAKU"
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të O.E	METE BYTYQI
Nënshkrimi:	
Data:	01.06.2020

Plani dinamik përishin periudhen prej 70 ditë pune.





ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta kenë

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 8526

Për **KOMUNA GLLOGOC**

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të **N.P." KONAKU "**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **LOT III NDËRTIMI I KOLEKTOREVE PËR GRUMBULLIMIN E UJERAVE TË ZEZA /AZHDIM I PUNIMEVE TË KOLEKTOREVE NE DRENAS –POLAC PERFUNDIMI I RRJETI KRYESOR**

Nr. prokurimit: 611-20-1771-5-2-1 , Nr. brendshëm: 611-20-036-521

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu eferuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **10,556.55€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet nospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **10,556.55€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 100 ditë kalendarike prej **06.08.2020** deri më **14.11.2020**

Data lëshimit: 06.08.2020

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Nr i Serisë

0046208